

## GJYKATA E APELIT

**Numri i lëndës:** PAKR 69/13

**Data:** 28 maj 2013

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, dhe gjyqtarëve Tonka Berisha dhe Xhevdet Abazi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Beti Hohler, zyrtare ligjore e EULEX-it, e cila vepron si procesmbajtëse,

në procedurën penale kundër

- 1. Sh.K.**, emri i të atit B., emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë së saj **S.B.**, i lindur më... në..., me vendbanim në..., rruga..., ..., ..., me gjendje ekonomike të dobët, në paraburgim që nga data 13.02.2009 deri më 21.02.2012,

*i akuzuar për veprat penale në vijim sipas aktakuzës nr. PPS 03/09 të datës 07.08.2009 të ndryshuar përmes aktvendimit të gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës nr. KA 128/2009 të datës 24.09.2009: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në pajtueshmëri me nenin 229 paragrafi (4) pika 1) të Kodit Penal të Kosovës 2004 (KPK);*

- 2. N.M.**, emri i të atit **G.M.**, emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë së saj **S. Th.**, i lindur më ... në ..., me vendbanim në ..., ..., me gjendje të mirë ekonomike, në paraburgim që nga data 13.02.2009 deri më 21.02.2012,

*i akuzuar për veprat penale në vijim sipas aktakuzës nr. PPS 03/09 të datës 07.08.2009 të ndryshuar përmes aktvendimit të gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës nr. KA 128/2009 të datës 24.09.2009: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në pajtueshmëri me nenin 229 paragrafin (4) pika 1) të KPK-së*

dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në pajtueshmëri me nenin 328 paragrafi (2) të KPK-së;

3. **M.S.**, emri i të atit **A.S.**, emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë së saj **Z.D.**, i lindur më ... në ..., me vendbanim në ...rruga ....., ..., ..., me gjendje financiare të mesme, në paraburgim që nga data 13.02.2009 deri më 21.02.2012,

*i akuzuar për veprat penale në vijim sipas aktakuzës nr. PPS 03/09 të datës 07.08.2009 të ndryshuar përmes aktvendimit të gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës nr. KA 128/2009 të datës 24.09.2009: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në pajtueshmëri me nenin 229 paragrafi (4) pika 1) të KPK-së;*

4. **A.R.**, emri i të atit **R.**, emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë së saj **H.K.**, i lindur më... në..., me vendbanim në ..., ..., ..., me gjendje ekonomike të mesme, në paraburgim që nga data 09.09.2009 deri më 21.02.2012,

*i akuzuar për veprat penale në vijim sipas aktakuzës nr. PPS 03/09 të datës 30.09.2009: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në pajtueshmëri me nenin 229 paragrafi (4) pika 1) të KPK-së;*

të gjitha akuzat kundër katër të akuzuarve janë refuzuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren nr. P 241/11 të datës 23.05.2012 në pajtueshmëri me nenin 389 pika 4) të KPPK-së,

**duke vepruar sipas ankesës së prokurorit special nr. PPS 03/2009 të datës 03.07.2012 dhe të paraqitur më 06.07.2012 në (atëherë) Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren nr. P 241/11 të datës 23.05.2012,**

*duke pasur parasysh përgjigjet e mbrojtjes respektivisht përgjigjen në ankesë të ushtruar nga avokati mbrojtës Hazer Susuri në emër të **N.M.** më 16.07.2012, përgjigjen në ankesë të ushtruar nga avokati mbrojtës Hajrip Krasniqi në emër të të pandehurit **M.S.** më 16.07.2012;*

*pas shqyrtimit të mendimit të prokurorit të shtetit të apelit nr. PPA 369/11 të datës 14.09.2012 dhe të paraqitur më 17.09.2012;*

*pas mbajtjes së seancës së hapur në pajtueshmëri me nenin 410 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)<sup>1</sup> më 28.05.2013 në praninë e të akuzuarit **Sh.K, N.M.** dhe **A.R.**, avokatëve mbrojtës Haser Susuri dhe Kosovare Kelmendi, dhe prokurorit të shteti të apelit Idain Smaili;*

*pas këshillimit dhe votimit më 28.05.2013,*

*në pajtueshmëri me nenet 420 dhe më tej të KPPK-së;*

*lëshon këtë*

---

## **AKTVENDIM MBI ANKESËN KUNDËR AKTGJYKIMIT**

---

**I. Ankesa e prokurorit special nr. PPS 03/2009 e datës 03.07.2012 dhe e paraqitur më 06.07.2012 në (atëherë) Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren nr. P 241/11 të datës 23.05.2012 përmes këtij aktvendimi pranohet.**

**II. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren nr. P 241/11 i datës 23.05.2012, me të cilin refuzohen akuzat kundër të pandehurve Sh.K, N.M., M.S. dhe A.R., përmes këtij aktvendimi ANULOHET DHE LËNDA KTËHEHET NË RIGJYKIM në Gjykatën Themelore në Prizren.**

### ARSYETIMI

#### **I. Historia e procedurës së lëndës**

1. Aktakuza nr. PPS 03/09 kundër të akuzuarve **Sh. K, N.M.** dhe **M.S.** është ngritur më 07.08.2009. Aktakuza u ndryshua dhe u konfirmua përmes aktvendimit të gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës të Gjykatës së Qarkut në Prizren nr. KA 128/09 të datës 24.09.2009. Aktakuza kundër **A.R.** e datës 30.09.2009 u ngrit më 02.10.2009 dhe u konfirmua përmes aktvendimi të gjyqtarit konfirmues të Gjykatës së Qarkut në Prizren më 14.10.2009.

---

<sup>1</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në fuqi që nga 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

2. Shqyrtimi gjyqësor i parë kundër të pandehurve filloi më 20.10.2009. (Ish) Gjykata e Qarkut në Prizren më 09.02.2010 shpalli aktgjykimin nr. P 159/09, duke gjetur të pandehurit fajtor për veprat penale të ngarkuara. Duke vepruar sipas ankesave të mbrojtjes kundër këtij aktgjykimi, Gjykata Supreme e Kosovës më 26.07.2011 nxori aktvendimin me të cilin pranoi ankesat e mbrojtjes. Gjykata Supreme prishi aktgjykimin e datës 09.02.2010 dhe e ktheu lëndën për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

3. Seancat e rigjyimit në Gjykatën e Qarkut në Prizren në lëndë u mbajtën më 20.02.2012, 07.03.2012, 21.05.2012 para një trupi gjykues të ri. Gjykata më 17.01.2012 në përgatitje për shqyrtimin gjyqësor mbajti edhe një seancë dëgjimore preliminare.

4. Trupi gjykues shpalli aktgjykimin e tij (aktgjykimi nr. P 241/11) më 23.05.2012 (tash e tutje: aktgjykimi i kundërshtuar). Trupi gjykues refuzoi akuzat kundër katër të pandehurve mbi bazën se ndjekja penale është e bllokuar në pajtueshmëri me nenin 389 pika 4) të KPPK-së. Trupi gjykues në pajtueshmëri me nenin 229 paragrafi (5) të KPK-së konfiskoi substancat narkotike me peshë të përgjithshme prej 13.882 kg; në pajtueshmëri me nenin 328 paragrafi (5) të KPK-së sekuestroi edhe një pistoletë me numër serik C-211115 bashkë me një karikator dhe 8 fishek; në pajtueshmëri me nenin 251 të KPPK-së, veturën Mercedes-Benz me tabela të regjistrimit 319-KS-777 e ktheu tek pronari i saj i regjistruar dhe caktoi që të paguhen të gjitha shpenzimet e nevojshme të të akuzuarve në procedurën penale nga burimet buxhetore.

5. Aktgjykimi i arsyetuar u është dërguar palëve në fund të qershorit – fillim të korrikut 2012.<sup>2</sup>

6. Gjykata e Apelit ka para vetes ankesën e prokurorisë kundër aktgjyimit të kundërshtuar. Ankesa është paraqitur më 6.07.2013.

7. Gjykata e Apelit mbajti një seancë të hapur në lëndë më 28.05.2013. Të gjithë të pandehurit, avokatët e tyre mbrojtës dhe prokurori i apelit i shtetit janë ftuar me rregull në seancë, sikurse provohet me fletë dërgesat e kthyer në shkresat e lëndës. I akuzuari **M.S.** dhe avokatët mbrojtës Fazli Balaj, Hajrip Krasniqi dhe Ruzdhi Gashi nuk kanë marrë pjesë në seancë. Më gjithë mungesën e tyre, kolegji mbajti seancën në përputhshmëri me nenin 410 paragrafin (4) të KPPK-së.

---

<sup>2</sup> Për datat e sakta të dërgimit, referim është bërë në fletë dërgesa me të cilat dokumentohet dërgimi i aktgjyimit tek të pandehurit, avokatët e tyre mbrojtës dhe prokuroria.

## II. Parashtrësit e palëve

### II.1. Ankesa e prokurorit special

8. Prokurori special kundërshton aktgjykimin e atakuar mbi bazën e shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, mbi bazën e shkeljes së ligjit penal dhe mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 402 paragrafi (1) nën paragrafët 1) deri 3) të KPPK-së). Ai kërkon që Gjykata e Apelit të prish aktgjykimin e kundërshtuar dhe të kthejë lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

9. Prokurori special rendit në vijim shkeljet substanciale të procedurës penale në pajtueshmëri me nenin 403 të KPPK-së:

- **shkelje substanciale e procedurës penale në pajtueshmëri me nenin 403 paragrafi (1) nën paragrafi 3) të KPPK-së**, sepse seanca gjyqësore e datës 21.05.2012 është mbajtur në mungesë të përkthyesit ... për të akuzuarin **Sh.K**;
- **shkelje substanciale e procedurës penale në pajtueshmëri me nenin 403 paragrafi (1) nën paragrafi 8) të KPPK-së**, sepse aktgjykimi i kundërshtuar u bazua në prova të papranueshme respektivisht në raportin përmbledhës “Rambujeja” të përgatitur nga dëshmitari A.O. i datës 19.03.2012. Sipas ligjit ky raport nuk cilësohet si provë dhe kjo është arsyeja pse hartuesi i raportit – dëshmitari A.O. – u propozua të dëgjohej si dëshmitar në procedurë. Madje edhe mbrojtja kundërshtoi pranueshmërin e raportit si provë. Trupi gjykues shkeli dispozitat e procedurës penale kur në vend të vendosjes sipas propozimeve të prokurorit, menjëherë shpalli aktgjykimin pa përfunduar procedurën provuese dhe pa dëgjuar fjalën përfundimtare të palëve;
- **shkelje substanciale e procedurës penale në pajtueshmëri me nenin 403 paragrafi (1) nën paragrafin 12) të KPPK-së**, sepse dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është në kundërshtim me pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të kundërshtuar. Gjithashtu aktgjykimi nuk përmban aspak arsyetim sa i përket fakteve kyçe. Dispozitivi i referohet nenit 389 pika (4) të KPPK-së si bazë ligjore për refuzimin e akuzave i cili do të sillte se akuzat u refuzuan për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit. Arsyetimi nuk përmban asgjë lidhur me kalimin e afatit të parashkrimit. Përkundrazi, trupi gjykues arsyetoi se provat e grumbulluara gjatë hetimit janë të papranueshme, në fakt, pohoi se kjo ishte

arsyeja pse u refuzuan akuzat. Çështja, prandaj, ngritët nëse aktgjykimi u soll për shkak kalimit të afatit të parashkrimit apo mungesës së provave të pranueshme. Për më tepër, trupi gjykues refuzoi edhe akuzën për *krim të organizuar* përkundër faktit se kjo akuzë nuk u konfirmua, prandaj, të pandehurit nuk u gjykuan aspak për këtë vepër penale. Sa i përket konfiskimit, asnjë arsyetimi nuk është dhënë për këtë në aktgjykimin e kundërshtuar. Trupi gjykues, po ashtu, nuk ka dhënë asnjë arsye pse vendosi të shpall provat të papranueshme;

- **shkelje substanciale e procedurës penale në pajtueshmëri me nenin 403 paragrafi (2) nën paragrafët 1) dhe 2) të KPPK-së**, sepse trupi gjykues nuk veproi në përputhshmëri me nenet 360, 371, 372, 373, 374, 378, 379, 381, 382 dhe 383 të KPPK-së dhe kjo pati ndikim në vendimin e gjykatës. Trupi gjykues nuk ka administruar provat e renditura në aktakuzë dhe të mbledhura në gjykimin paraprak. Ai shkeli rregullat për zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor kur dorëzoi aktgjykimin pa ftuar dëshmitarët dhe kur palëve nuk iu dha mundësia të propozojnë prova të reja, të marrin në pyetje të akuzuarit dhe të dhënë fjalën e tyre përfundimtare.

10. Ankesa më tej shqyrton pranueshmërin e provave të grumbulluara nga masat e fshehta sipas nenit 258 paragrafi (1) pika 1) (fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vendet publike) të KPPK-së.

11. Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ankesa përmban se me shkeljen e dispozitave procedurale të shqyrtimit gjyqësor dhe duke zbatuar gabimisht dispozitat e KPPK-së, trupi gjykues nuk vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë korrekte. Kjo, në kthim, rezultoi edhe në shkelje të ligjit penal pasi akuzuat kundër të akuzuarve u refuzuan.

## **II.2. Përgjigjet e mbrojtjes**

12. Avokatët mbrojtës të **N.M.** dhe **M.S.** paraqitën përgjigjet në ankesën e prokurorisë. Avokatët mbrojtës propozuan të refuzohet ankesa e prokurorisë dhe të vërtetohet aktgjykimi i kundërshtuar.

13. Avokati mbrojtës Hajrip Krasniqi në ankesën e ushtruar në emër të **M.S.** kundërshton pretendimet e ankesës se aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në prova të papranueshme. Ai vëren se dëshmitari A.O. është ftuar në cilësinë e dëshmitarit, ai dëshmoi dhe ajo dëshmi është provë

në lëndë. Raporti i datës 19.03.2012 është paraqitur nga prokuroria sepse kryetari i kolegjit kërkoi për sqarime të rrethanave të lëndës.

14. Avokati mbrojtës thekson se gjatë gjithë procedurës fakti se blerja e narkotikëve ishte një blerje e stimuluar, është fshehur qëllimisht ose rastësisht.

15. Pohimi i prokurorisë se arsyetimi i aktgjyqimit të kundërshtuar nuk ka analizuar provat është i pabazuar sepse trupi gjykues në mënyrë të qartë pohon në arsyetim pse nuk ka pasur vlerësim dhe analizë të provave. Edhe pohimet e prokurorit se dispozitat e neneve nga 360 deri te 383 të KPPK-së janë shkelur dhe se shkelja ndikoi në marrjen e një vendimi të ligjshëm, nuk qëndrojnë. Refuzimi i akuzës ishte pasojë e aktakuzës të bazuar në veprime të kundërligjshme dhe jo nga mos-veprimet e trupit gjykues. Njëherazi palëve u është dhënë kohë e arsyeshme të paraqesin argumentet e tyre gjatë gjyqimit.

16. Avokati mbrojtës Hazer Susuri paraqiti përgjigje në emër të të akuzuarit **N.M.**. Në përgjigjen e tij në ankesën e prokurorisë, ai argumenton se kundërshtimet ndaj aktgjyqimit të kundërshtuar janë të pabazuara. Sa i përket mungesës së një përkthyesi të gjuhës turke më datën 21.05.2012, nuk ka pasur shkelje të procedurës pasi që i akuzuari deklaroi se ai e kupton gjuhën shqipe. Më tej avokati mbrojtës vë në pah se nuk është aktgjykimi ai që është i bazuar në prova të papranueshme por se vet aktakuza është iniciuar sipas provave të papranueshme prandaj aktgjykimi në mënyrë korrekte refuzoi akuzat. Më tutje ai shtjellon mbi pranueshmërin e provave të grumbulluara përmes masave të fshehta dhe mbi deklarin e dhënë nga dëshmitari A.O..

17. Ai nxjerr përfundimin se marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe marrja e mëtejme në pyetje e A.O. nuk do të ishte ligjore pasi që nuk ka pasur urdhëresë për masa të fshehta; prandaj nuk ka pasur nevojë të vazhdohet me procedurën e provave e as për fjalën përfundimtare.

18. Ai thekson se dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjyqimit të kundërshtuar nuk janë kontradiktor. Akuza nuk është refuzuar për shkak të afatit të parashkrimit por për shkak të rrethanave të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale. Aktgjykimi i kundërshtuar në mënyrë korrekte përmban se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të KPPK-së sepse nuk është dhënë asnjë urdhëresë gjyqësore për blerje të stimuluar të drogës sikurse kërkohet me nenin 258 paragrafin (2) pika 8) të KPPK-së. Më tej, refuzimi i akuzës së *krim i organizuar* që nuk ishte akuzë e konfirmuar, nuk mund të konsiderohet si shkelje substanciale e procedurës penale pasi që pasojat e këtij refuzimi nuk janë

relevante. Gjithashtu mos tregimi i llojit të narkotikëve dhe personi nga i cili është sekuestruar arma nuk është shkelje esenciale e ligjit. Avokati mbrojtës thekson se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të mbrojtjes gjatë shqyrtimit gjyqësor.

19. Lidhur me pretendimet në ankesë se gjendja faktike u vërtetua gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë, këto pretendime po ashtu janë të pabazuara. Aktgjykimit me të drejtë dhe plotësisht vërtetoi gjendjen faktike kur refuzoi akuzën. Prokuroria nuk ka mundur të sjell prova të ligjshme për të mbështetur aktakuzën. Provat e reja të propozuar nga prokurori nuk ishin të nevojshme dhe do të ishin të kundërligjshme e edhe provat e renditura në ankesën e prokurorit janë të papranueshme. Nuk ka pasur shkelje të Kodit Penal të Kosovës pasi që aktgjykimi i kundërshtuar është nxjerrë në të mirë të të akuzuarve përmes refuzimit të akuzës.

### **II.3. Mendimi i prokurorit të shtetit të apelit**

20. Prokurorja e shtetit e apelit mbështet ankesën e paraqitur nga prokurori special dhe në mendimin e saj ajo kryesisht përsërit arsyetimin e ankesës. Ajo i propozon Gjykatës së Apelit të pranoj ankesën dhe ta kthej lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim.

## **III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

### **III.1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit**

21. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur për ankesën në pajtueshmëri me nenet 17 dhe 18 të Ligjit mbi Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199). Lënda ishte në pritje në Gjykatën Supreme më 31.12.2012 si lëndë e shkallës së dytë dhe prandaj është në përputhshmëri me nenin 39 paragrafin (1) të Ligjit mbi Gjykatat nga data 01.01.2013 e trajtuar si lëndë në pritje në Gjykatën e Apelit.

22. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi Gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053). Në pajtueshmëri me vendimin e kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nr. 2013.OPEJ.0239-001 të datës 22.05.2013, të marr në përputhshmëri me nenin 3.7. të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të

EULEX-it në Kosovë, kolegji ishte i përbërë prej një gjyqtari të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

### **III.2 Ligji procedural i zbatueshëm - *mutatis mutandis* Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në fuqi deri më 31.12.2012**

23. Gjykata e Apelit e konstaton të duhur të ritheksoj se ligji procedural i aplikueshëm në lëndën penale përkatëse është Kodi i procedurës penale (i vjetri) të Kosovës që ishte në fuqi deri më 31.12.2012.<sup>3</sup> Interpretimi i duhur i dispozitave kalimtare të Kodit (të ri) të procedurës penale (KPK), në fuqi që nga data 01.01.2013, parasheh që në procedurat penale të iniciuara para hyrjes në fuqi të kodit të ri, e për të cilat gjykimi tanimë ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, do të zbatohen *përshmtashmërisht* dispozitat e KPPK-së derisa vendimi të marrë formën e prerë. Lidhur me këtë, është përmendur Mendimi juridik nr. 56/2013 i Gjykatës Supreme të Kosovës i nxjerr në seancën e përgjithshme të saj më datën 23.01.2013.

### **III. 3. Pranueshmëria e ankesës**

24. Aktgjykimi i kontestuar është shpallur më datën 23.05.2012. Aktgjykimi në formën e shkruar i është dërguar prokurorit special më 02.07.2012, siç dokumentohet edhe me fletë-dërgesën në shkresat e lëndës. Prokurori special ka paralajmëruar ushtrimin e ankesës menjëherë pas marrjes së aktgjykimit, në seancën e datës 23.05.2013. Prokurori special ka ushtruar ankesën më 6 korrik 2013. Gjykata e Apelit gjen se ankesa është ushtruar nga personi i autorizuar dhe brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 398, par. (1) të KPPK-së dhe me nenin 399, par. (1) të KPPK-së.

### **III. 4. Gjetjet lidhur me meritat**

*(a) Shkelja siç pohohet esenciale e procedurës penale në bazë të nenit 403, par. (1), nënpar. 12) të KPPK-së dhe shkelja siç pohohet esenciale e procedurës penale në bazë të nenit 403, par. (2), nënpar. 1) dhe 2) të KPPK-së*

25. Trupi gjykues ka refuzuar akuzat ndaj të pandehurve në bazë të nenit 389, pika 4) të KPPK-së. Dispozita ligjore përkatëse përmban: “Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur

---

<sup>3</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në fuqi nga data 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

[...] ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti a falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.”

26. Prokurori special në ankesën e tij pretendon se trupi gjykues ka refuzuar akuzën për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit dhe pretendon se arsyetimi nuk përmban ndonjë sqarim në këtë drejtim dhe si pasojë nuk përputhet me dispozitivin.

27. Trupi gjykues askund në aktgjykimin e kundërshtuar nuk i është referuar skadimit të afatit të parashkrimit. Trupi gjykues, siç shpjegohet në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të kundërshtuar, ka refuzuar akuzat për arsye se ka konsideruar se *ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë ndjekjen penale* e jo për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit. Trupi gjykues ka arsyetuar këtë për shkak se prokurori special nuk ka pasur mundësinë të lëshojë urdhrat gjyqësorë mbi të cilat janë mbështetur veprimet policore të datës 12 shkurt 2009, ka qenë e pamundur të vlerësohet pranueshmëria e provave të paraqitura nga prokurori dhe si pasojë e kësaj nuk ka pasur mundësi të vërtetohet nëse ndjekja penale është bërë në përputhje me nenin 1 të KPPK-së. Trupi gjykues ka konstatuar se “kjo gjë sipas interpretimit të prokurorit shpie gjer tek përjashtimi i ndjekjes penale.”<sup>4</sup>

28. Në esencë, trupi gjykues ka konsideruar se pamundësia për të verifikuar nëse veprimet e prokurorit special kanë qenë të ligjshme apo jo, kanë çuar tek rrethanat e përjashtimit të ndjekjes penale në kuptim të nenit 389, pikës 4) të KPPK-së. Trupi gjykues ka shpjeguar mënyrën e saj të arsyetimit me qartësi të mjaftueshme në aktgjykim. Gjykata e Apelit nuk gjen mospërputhje në mes të dispozitivit (i referohemi nenit 389, pika 4 e KPPK-së) dhe të pjesës së arsyetimit të aktgjykimit të kundërshtuar.

29. Megjithatë, Gjykata e Apelit konstaton se trupi gjykues ka zbatuar gabimisht nenin 389, pikën 4) të KPPK-së dhe se kjo gjë ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

30. Aktgjykimi për refuzimin e akuzave nuk nënkupton vlerësimin e meritave të lëndës, por i njëjti merret për shkak se *parakushti i procedurës formale* nuk është plotësuar ose më nuk mund të plotësohet.

---

<sup>4</sup> Shih aktgjykimin e kundërshtuar, faqe 5 e versionit në gjuhën angleze.

31. Neni 389 i KPPK-së rregullon marrjen e aktgjykimit mbi refuzimin e akuzave. Sipas këtij neni, gjykata merr aktgjykim të tillë kur më nuk ka akuza të vlefshme ndaj të pandehurit (prokurori ka tërhequr akuzën në periudhën ndërmjet hapjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor ose pala e dëmtuar ka tërhequr propozimin për ndjekje penale kur një propozim i tillë është parakusht sipas KPK-së) ose kur i akuzuari është shpallur fajtor / është liruar me aktgjykimin e formës së prerë ose kur procedura është ndërprerë për të njëjtën veprë (manifestimi i parimit *ne bis in idem*), ose kur afati i parashkrimit ka skaduar dhe vepra përfshihet në amnisti a falje ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.

32. Gjukata e Apelit, duke u mbështetur në interpretimin teleologjik dhe sistematik të dispozitës, gjen se termi “rrethana tjera që përjashtojnë ndjekjen penale” në nenin 389, pikën 4) të KPPK-së u referohet kushteve të tjera procedurale të ndryshme nga ato të cilat përmenden në mënyrë specifike por që kanë natyrë të ngjashme dhe të cilat ndikojnë në procedurën penale. Shembuj të këtyre rrethanave janë vdekja e të akuzuarit, ose imuniteti i të akuzuarit nga ndjekja penale. Këto rrethana duhet patjetër të jenë të natyrës formale dhe që nuk supozojnë asnjë rishikim të provave apo rishikim të meritave.

33. Në të gjitha rastet e tjera, kur trupi gjykues do të angazhohej në çfarëdo lloji të rishikimit të provave, qoftë edhe në vërtetimin se ndjekja është iniciuar dhe është e mbështetur në prova të siguruar në mënyrë të kundërligjshme, gjykata duhet patjetër të marrë aktgjykimin meritator. Po qe se gjykata gjen se prova në të cilën mbështetet prokuroria është e papranueshme dhe se prokuroria pastaj nuk ka provuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën ai ose ajo është akuzuar, gjykata duhet të marrë aktgjykimin shfajësues në përputhje me nenin 390, pikën 3) të KPPK-së.

34. Trupi gjykues me të drejtë ka theksuar në aktgjykimin e kundërshtuar se në bazë të nenit 1 të KPPK-së, ndjekja penale e veprave duhet të bëhet në përputhje me ligjin dhe se shkeljet e ligjit mund të rezultojnë në shpalljen e provave si të papranueshme. Trupi gjykues pastaj në vend se të vërtetojë se provat janë të papranueshme dhe pastaj të vazhdojë me shqyrtimin gjyqësor në përputhje me KPPK-në, ka konstatuar se nuk ka mundësi të vlerësojë pranueshmërinë dhe prandaj përjashtohet ndjekja penale në këtë lëndë. Gjukata e Apelit gjen se leximi i këtillë i ligjit nuk ka mbështetje në KPPK.

35. Trupi gjykues nuk ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë të gabuar një varg dispozitash të KPPK-së. Trupi gjykues ka treguar mungesë serioze të të kuptuarit të procedurës penale sipas KPPK-së.

36. Trupi gjykues, duke pasur parasysh raportin e fundit policor të datës 19.03.2012 dhe pas propozimeve të mbrojtjes për shpalljen e provave si të papranueshme, ka qenë i obliguar që për këtë arsye të lëshojë aktvendimin e arsyetuar në pajtim me nenin 154, par. (1) të KPPK-së, d.m.th. përmes shpalljes së provave qoftë të pranueshme apo të papranueshme, mirëpo ky trup gjykues nuk ka bërë një gjë të tillë.

37. Në qoftë se trupi gjykues ka konsideruar se prokurori special nuk ka lëshuar urdhrin gjyqësor të përcaktuar me nenin 258, par. (4) të KPPK-së, atëherë është dashur t'i shpallte provat të papranueshme në pajtim me nenin 153, par. (1) të KPPK-së, lidhur me nenin 264, par. (1) të KPPK-së, pastaj t'i largonte nga shkresat e lëndës provat e papranueshme në përputhje me nenin 154, par. (4) të KPPK-së, dhe është dashur të vazhdonte me shqyrtimin gjyqësor në përputhje me nenet 360 *et seq* (dhe ato që pasojnë) të KPPK-së. Pas përmbylljes së shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues ka qenë i obliguar të shqyrtonte dhe të vlerësonte të gjitha provat (e pranueshme) dhe të kthente aktgjykimin e duhur meritior. Edhe në qoftë se trupi gjykues ka shpallur si të papranueshme provat përkatëse të cilat në pikëpyetje paraqesin vetëm thelbin e akuzave ndaj të pandehurve, prapëseprapë i njëjti trup ka qenë prapë i obliguar të bëjë vlerësimin e provave të tjera në shkresat e lëndës, të vendosë mbi propozimet e pazgjidhura për prova, të ekzaminonte të akuzuarin, të dëgjonte fjalën përfundimtare dhe përfundimisht të kthente aktgjykimin meritior.

38. Gjykata e Apelit gjen se zbatimi i gabueshëm i nenit 389, pikës 4) të KPPK-së dhe moszbatimi i neneve 360, 371, 372, 373, 374, 378, 379, 381, 382, dhe 383 të KPPK-së kanë ndikuar në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë.

39. Nuk ka ekzistuar baza ligjore për sjelljen e aktgjyimit me të cilin janë refuzuar akuzat. Trupi gjykues është dashur të nxirrte aktgjykimin meritior. Trupi gjykues është dashur të prononcohej lidhur me pranueshmërinë e provave dhe t'i vlerësonte faktet dhe provat në aktgjykim. Trupi gjykues nuk e ka bërë këtë, prandaj aktgjykimin i kundërshtuar si pasojë nuk përmban asnjë deklaram rreth fakteve materiale.

Gjykata e Apelit gjen se ka pasur shkelje esenciale të procedurës penale në bazë të nenit 403, par. (2), nënpar. 1) të KPPK-së.

40. Prokurori special në ankesën e vet po ashtu pretendon se trupi gjykues nuk kishte dhënë kurrfarë arsytimi lidhur me pjesën e dispozitivit e cila ka të bëjë me konfiskimin.

41. Lidhur me deklaratimet tjera në aktgjykimin e kundërshtuar, trupi gjykues ka ofruar arsytimin e vet vetëm lidhur me kthimin e veturës Mercedes Benz.

42. Gjykata e Apelit gjen se trupi gjykues jo vetëm që ka dështuar në dhënien e arsytimit për konfiskim në aktgjykimin e kundërshtuar por gjithashtu edhe ka zbatuar bazën e gabuar ligjore për konfiskim.

43. Trupi gjykues ka zbatuar nenin 229, par. (5) të KPK-së si bazë ligjore për konfiskimin e substancave narkotike dhe nenin 328, par. (5) të KPK-së si bazë ligjore për konfiskimin e revoles së sekuestruar.

Gjykata e Apelit gjen se the trupi gjykues nuk ka zbatuar bazën e duhur ligjore dhe gjithashtu nuk ka arsyetuar vendimin e saj mbi konfiskimin e narkotikëve dhe të armës së zjarrit.

44. Trupi gjykues është dashur të zbatonte nenin 489, par. (1) të KPPK-së **lidhur me** nenet 229, par. (5) të KPK-së dhe 328, par. (5) të KPK-së. Është neni 489, par. (1) i KPPK-së i cili ofron bazën ligjore për konfiskimin madje edhe në rastet kur nuk lëshohet aktgjykim dënues. Referimi vetëm i nenit 229, par. (5) dhe i nenit 328, par. (5) të KPK-së do të nënkuptonte aktgjykimin dënues.<sup>5</sup>

45. Trupi gjykues po ashtu ka qenë i obliguar të arsyetojë vendimin e vet në pjesën e arsytimit të aktgjykimit të kundërshtuar. Trupi gjykues nuk ka ofruar kurrfarë arsytimi lidhur me këtë pjesë gjë e cila konsiderohet shkelje esenciale e ligjit të procedurës, e përcaktuar me nenin 403, par. (1), nënpar. (12) të KPPK-së. Trupi gjykues, siç u theksua nga prokurori, po ashtu nuk i referohet natyrës së narkotikëve (heroinë), edhe pse te një konstatim i tillë mund të vihet nga pjesët e tjera të aktgjykimit (p.sh. faqja 4 e versionit në gjuhën angleze, duke iu referuar heroinës) dhe nga shkresat e lëndës. Megjithëkëtë, Gjykata e Apelit përsërit edhe një herë se

---

<sup>5</sup> Kur i akuzuari shpallet fajtor për një veprë penale, ky konfiskim mbështetet në nenin 50 të KPK-së dhe në nenin specifik të pjesës së posaçme të KPK-së.

natyra e narkotikëve është dashur të sqarohet pa ekuivokë edhe në dispozitiv e shoqëruar po ashtu edhe me të dhënat e tjera identifikuese (d.m.th. me kohën kur janë sekuestruar këta narkotikë dhe prej kujt janë sekuestruar).

46. Prokurori special në ankesë po ashtu thekson se trupi gjykues në aktgjykimin e kundërshtuar ka refuzuar akuzën e *krimit të organizuar*, edhe pse kjo akuzë tashmë ishte refuzuar nga ana e gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës dhe nuk kishte qenë më pjesë e aktakuzës. Nuk është e qartë nëse prokurori special me një pohim të tillë përpiqet të pretendojë shkeljen e përcaktuar me nenin 403, par. (1), nënpar. 10) të KPPK-së – d.m.th. se aktgjykimi ka tejkalar akuzën.

47. Gjykata e Apelit gjen se referimi në veprën penale të *krimit të organizuar* në dispozitiv bëhet në formë të citimit të nenit 274, par. (1) të KPK-së lidhur me të pandehurit **N.M.** dhe **M.S.** por jo për të pandehurin **Sh.K.** Lidhur me të pandehurin **Sh.K.**, trupi gjykues i referohet ndryshimit të aktakuzës përmes aktvendimit të gjyqtarit konfirmues dhe nuk e përmend nenin 274, par. (1) të KPK-së në mesin e akuzave. Nga ana tjetër, përkitazi me dy të pandehurit e tjerë (**N.M.**, **M.S.**), referimi i bëhet vetëm aktakuzës origjinale PPS 03 / 09 të datës 07.08.2009 ndërsa trupi gjykues vazhdon që në mesin e akuzave ta fut edhe nenin 274, par. (1) të KPK-së. Duket se trupi gjykues për ndonjë arsye ka konsideruar se ndryshimi i aktakuzës përmes aktvendimit konfirmues të datës 24 shtator 2009 ka të bëjë vetëm me të pandehurin **Sh.K.**, gjë e cila nuk është e saktë. Gjyqtari konfirmues pa asnjë ekuivokë ka refuzuar akuzën e *krimit të organizuar* lidhur me të tre të akuzuarit. Aktakuza është konfirmuar vetëm për veprën penale të përcaktuar me nenin 229, par. (4), pikën 1) të KPK-së, prandaj kjo akuzë është e vetmja akuzë që ka mbetur në raport me të gjithë të akuzuarit. Duhet të përmendet se i akuzuari **A.R.** kurrë nuk është akuzuar me veprën penale të kimit të organizuar, gjë e cila është evidente nga aktakuza nr. PPS 03 / 09 e datës 30.09.2009 e cila ishte ngritur ndaj tij.

*(b) Pohimi rreth shkeljes esenciale të procedurës penale sipas nenit 403, par. (1), nënpar.*

*3) të KPPK-së*

48. Prokurori special pohon se e drejta për të pasur përkthyes ... për të akuzuarin **Sh. K.** është shkelur në procedurën penale të datës 21 maj 2012 gjë e cila konsiderohet shkelje esenciale e procedurës penale e përcaktuar me nenin 403, par. (1), nënpar. 3) të KPPK-së. Avokati mbrojtës i të pandehurit **N.M.** pretendon se nuk ka pasur shkelje të këtillë pasi që i akuzuari në fjalë kishte

bërë publike se i njëjti e kuptonte gjuhën shqipe dhe se ishte në gjendje të ndiqte procedurën në gjuhën shqipe.

49. Gjykata e Apelit ka ekzaminuar procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe konfirmon se përkthyesi për gjuhën turke ka qenë i pranishëm në disa prej seancave por jo në të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor. Nuk ka pasur përkthyes ... së paku në njëërën pjesë të seancës së mbajtur më 07.03.2012 dhe më 21.05.2012.

50. Gjykata e Apelit posaçërisht i referohet procesverbalit të seancës së datës 07.03.2012 kur kemi të bëjmë me aftësinë e të pandehurve **Sh.K** dhe **N.M.** për të ndjekur procedurën gjyqësore në gjuhën shqipe. **Sh.K** ka konfirmuar se është i aftë për të ndjekur procesin gjyqësor në gjuhën shqipe e po ashtu edhe avokati mbrojtës i të pandehurit **N.M.** ka konfirmuar se edhe klienti i tij mund të kuptojë “gjuhën e përditshme”.<sup>6</sup> Në fund të seancës së datës 21 maj 2012, **N.M.** kishte thënë “deri këtu e kuptuam, por tash e tutje nuk ma merr mendja se do ta kuptoj.”<sup>7</sup> Në seancën e datës 21.05.2012, **Sh.K.** kishte konfirmuar se e kishte kuptuar procedurën gjyqësore.<sup>8</sup> Gjykata e Apelit vëren se seanca e radhës – njëkohësisht seanca e fundit ishte mbajtur më datën 23.05.2013 kur edhe ishte shpallur aktgjykimi. Nga procesverbali i asaj seance nuk është e qartë nëse ka pasur përkthyes ... apo jo.

51. Gjykata e Apelit i jep peshë të veçantë pohimit të avokatit mbrojtës Susuri në përgjigjen e tij ndaj ankesës se i akuzuari ka qenë i aftë të ndiqte procedurën në gjuhën shqipe.

*Gjykata e Apelit duke pasur parasysh këtë e refuzon këtë arsye të ankesës së prokurorit special.*

52. Gjykata e Apelit megjithatë vëren se është e rëndësishme që trupi gjykues të verifikojë qysh në fillim të shqyrtimit gjyqësor se të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë gjuhën në të cilën mbahet gjykimi dhe se, në qoftë se është e nevojshme, të sigurojë përkthimin e duhur për të pandehurit gjatë tërë gjykimit, duke përfshirë këtu edhe përkthimin me shkrim të aktvendimeve dhe të aktgjykimit.

**(c) Pohimi rreth shkëljes esenciale të procedurës penale sipas nenit 403, par. (1), nënpar. 8) të KPPK-së**

<sup>6</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 07.03.2013, faqe 10 (versioni në gjuhën angleze).

<sup>7</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 21.05.2012, faqe 5 (versioni në gjuhën angleze).

<sup>8</sup> Po aty.

53. Prokurori special deklaron se aktgjykimi i kundërshtuar është i mbështetur në prova të papranueshme. Një lexim i tillë i aktgjykimit të kundërshtuar, siç theksohet po ashtu edhe në përgjigjet e mbrojtjes, është i pasaktë. Siç është konstatuar tashmë nga Gjykata e Apelit, trupi gjykues në këtë rast, në të vërtetë nuk ka kthyer aktvendimin mbi pranueshmërinë e provave të kundërshtuara, të cilat supozohet se janë siguruar pa urdhëresën e vlefshme gjyqësore.

54. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk bazohet në prova të papranueshme por në zbatimin e gabueshëm të nenit 389, pikës 4) të KPPK-së.

*Për këtë arsye, refuzohet arsyeja në fjalë e ankesës së prokurorit special.*

55. Lidhur me atë se prokurori special diskuton pranueshmërinë e provave në këtë lëndë, Gjykata e Apelit vëren se çfarëdo vërtetimi i tillë i trupit gjykues duhet të bëhet në përputhje me nenin 153 të KPPK-së, nenin 258 të KPPK-së dhe nenin 264 të KPPK-së.

***(d) Pohimi rreth shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike***

56. Gjykata e Apelit pajtohet me prokurorin special se shkeljet e procedurës në këtë lëndë kanë rezultuar po ashtu edhe në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike.

57. Gjykata e Apelit gjen se për shkak të zbatimit të gabueshëm të nenit 389, pikës 4) të KPPK-së, trupi gjykues nuk ka vërtetuar fare gjendjen faktike.

*Gjykata e Apelit gjen se trupi gjykues nuk ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë lëndë gjë e cila konsiderohet shkelje në bazë të ligjit 405, par. (3) të KPPK-së.*

*Gjykata e Apelit nuk ka gjetur asnjë shkelje tjetër të ligjit penale në bazë të nenit 404 të KPPK-së, përveç shkeljes së vërtetuar më lart (lidhur me bazën ligjore për konfiskimin).*

#### **IV. Konkluzion**

58. Gjykata e Apelit ka pranuar ankesën e prokurorit special siç është shtjelluar më lart. Gjykata e Apelit ka konstatuar shkeljen esenciale të procedurës penale në bazë të nenit 403 të KPPK-së dhe vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike në bazë të nenit 405, par. (3) të KPPK-së. Gjykata e Apelit gjithashtu ka gjetur shkelje të ligjit penal në bazë të nenit 404, pikës 5) të KPPK-së (baza ligjore për konfiskim).

59. Në bazë të nenit 424, par. (1) të KPPK-së, Gjykata e Apelit e anulon aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit nr. P 241 / 2011 të datës 23.05.2013 si dhe e kthen lëndën për rigjykim i cili duhet të mbahet në Gjykatën Themelore të Prizrenit.

60. Asnjë nga të pandehurit nuk është duke u mbajtur në ndonjë masë kufizuese prandaj nuk ka prononcime në këtë aspekt.

61. Gjykata Themelore e Prizrenit do ta mbajë shqyrtimin e ri gjyqësor duke u bazuar në aktakuzën nr. PPS 03 / 09 të datës 07.08.2009 të ndryshuar me aktvendimin e gjyqtarit konfirmues nr. KA 128 / 2009 të datës 24.09.2009 (**Sh.K., N.M., M.S.**) dhe aktakuzën nr. PPS 03 / 09 të datës 30.09.2009 (**A.R.**). Gjykata e Apelit vëren se Gjykata Themelore duhet ta adresojë çështjen e pranueshmërisë së provave të siguruara lidhur me këtë lëndë, duke pasur parasysh informatat të cilat i përmban raporti i datës 19 mars 2013 si dhe ta mbajë rigjykimin në pajtim me ligjin. Trupi gjykues, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, duhet të konstatojë nëse ndonjëri prej të akuzuarve ka nevojë për përkthim ... me qëllim të ndjekjes së rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor në gjuhën amtare. Po qe se përkthimi është i nevojshëm, kjo gjë duhet të shënohet në mënyrë të rregullt në procesverbalin e secilës seancë të shqyrtimit gjyqësor.

62. Gjykata e Apelit vëren se në përputhje me dispozitën kalimtare të nenit 544 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), rigjykimi do të mbahet në përputhje me KPPK-në, d.m.th. në bazë të kodit të vjetër procedurës *mutatis mutandis*.

63. Për këtë arsye vendoset si në dispozitiv.

*Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë të autorizuar.*

Kryetarja e kolegjit

\_\_\_\_\_

Hajnalka Veronika Karpati

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

Anëtari i kolegjit

Tonka Berisha  
Gjyqtare

Xhevdet Abazi  
Gjyqtar

Procesmbajtësja

---

Beti Hohler  
Zyrtare ligjore e EULEX-it

*Aktvendimi i arsyetuar është përfunduar më datën 8 korrik 2013.*

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**Pakr 69 / 13**

**28 maj 2013**